



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1621/1 Prot

Tiranë, më 25.11.2019

V E N D I M

Nr.149, datë 25.11.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Finiq, në bazë të urdhrin nr. 65, datë 12.09.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në përgatitjen e strukturës dhe organigramës të kësaj bashkie”.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Finiq,

VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, me urdhrin nr. 65, (nr. 1453 prot), datë 12.09.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si edhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin

e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (*61 bashkitë e vendit*), ku përfshihet edhe Bashkia Finiq.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Këshilli i Bashkisë Finiq, Vendimin nr. 123, datë 17.12.2018, "*Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Finiq dhe Njësive Administrativ, institucioneve në varësi, si dhe numrin e përgjithshëm të punëtorëve për vitin 2019*", ka përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Finiq dhe njësive administrative e institucioneve në varësi të saj. Në zbatim të këtij vendimi, kryetari i Bashkisë Finiq, bazuar në nenin 64, shkronja "j", të ligjit nr.139/2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", ka nxjerrë Urdhërin nr.14/7, datë 23.08.2019, me të cilin ka miratuar strukturën organizative të institucionit, e cila ishte në fuqi edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas strukturës aktuale, Bashkia Finiq së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **49** pozicione pune të vlerësuara si pjesë të shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **1** pozicion pune i kategorisë së lartë drejtuese, **8** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese, **8** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese, dhe **32** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt, u konstatua se **17** pozicione pune të shërbimit civil janë plotësuar nëpërmjet procedurave të konkurrimit të përcaktuara nga ligji nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ose në zbatim të nenit 67 të këtij ligji; **32** pozicione të shërbimit civil, rezulton se aktualisht janë plotësuar me punonjës të punësuar me akt emërimi apo kontrata të përkohshme, dhe jo sipas një procedure konkurrimi të rregullt.

Konkretisht, rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin evidentohen si më poshtë, ku specifikohet pozicioni i punës dhe punonjësi që kryen aktualisht detyrën, si edhe akti i emërimit i nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. ***** "*Sekretar i Përgjithshëm*", aktualisht emëruar me aktin nr. 2300 prot., dt.23.08.2019.
2. ***** "*Drejtor*" në Drejtorinë e Financës, emëruar me aktin nr. 2079 prot., dt. 22.08.2016;
3. ***** "*Përgjegjës Finance*", në Drejtorinë e Financës, emëruar me aktin nr.266 prot., dt. 31.01.2019;
4. ***** "*Specialist e Barazisë Gjinore*", në Sektorin e Barazisë Gjinore, emëruar me aktin nr. 391 prot., dt. 06.02.2018;
5. ***** "*Përgjegjës*", në Drejtorinë e Financës, emëruar me aktin nr.91, dt. 05.09.2017;

6. ***** “*Specialsit Hartograf*”, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, emëruar me aktin nr. 132 prot., dt. 22.10.2018;
7. ***** “*Specialsit Topograf*”, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, emëruar me aktin nr. 1650 prot, dt. 30.06.2016;
8. ***** “*Specialsit IT*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, emëruar me aktin nr. 1399 prot., dt. 26.05.2018;
9. ***** “*Përgjegjës*”, në Drejtorinë e AMT, Veterinarisë, Mbrojtjes së Konsumatorit, emëruar me aktin nr. 2529 prot., dt. 04.09.2017;
10. ***** “*Specialist i Menaxhimit të Tokës*”, në Drejtorinë e AMT, Veterinarisë, Mbrojtjes së Konsumatorit, emëruar me aktin nr. 1462 prot., dt.03.06.2016;
11. ***** “*Specialist i Menaxhimit të Tokës*”, në Drejtorinë e AMT, Veterinarisë, Mbrojtjes së Konsumatorit, emëruar me aktin nr. 2469 prot., dt.18.09.2019;
12. ***** “*Specialist i Mbrojtjes së Konsumatorit*”, në Drejtorinë e AMT, Veterinarisë, Mbrojtjes së Konsumatorit, emëruar me aktin nr. 2517 prot., dt.09.09.2017;
13. ***** “*Specialist i Mbrojtjes së Konsumatorit*”, në Drejtorinë e AMT, Veterinarisë, Mbrojtjes së Konsumatorit, emëruar me aktin nr. 2110 prot., dt.25.08.2016;
14. ***** “*Drejtor i Pyjeve dhe Kullotave*”, në Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me aktin nr. 26024 prot., dt. 23.09.2019;
15. ***** “*Specialist*”, në Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me aktin nr.1199 prot., dt. 21.04.2017;
16. ***** “*Specialist*”, në Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me aktin nr. 1519 prot., dt. 06.06.2018;
17. ***** “*Inspektor Taksash*”, në Drejtorinë e Tarifave dhe Taksave, emëruar me aktin nr. 2472 prot., dt. 10.09.2019;
18. ***** “*Inspektor Taksash*”, në Drejtorinë e Tarifave dhe Taksave, emëruar me aktin nr. 16, dt. 29.09.2015;
19. ***** “*Inspektor Taksash*”, në Drejtorinë e Tarifave dhe Taksave, emëruar me aktin nr.15, dt. 29.09.2015;
20. ***** “*Inspektor Taksash*”, në Drejtorinë e Tarifave dhe Taksave, emëruar me aktin nr.19, dt. 29.09.2019;
21. ***** “*Drejtor i Programim Zhvillimit*”, në Drejtorinë e Programim-Zhvillimit të Projekteve, Turizmit, Mjedisit dhe Arsimit, emëruar me aktin nr. 653 prot., dt. 02.03.2018;
22. ***** “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin për Aplikimin e Projekteve, Turizmit dhe Sporteve, emëruar me aktin nr.2613 prot., dt. 01.10.2018;
23. ***** “*Specialist Turizmi*”, në Sektorin për Aplikimin e Projekteve, Turizmit dhe Sporteve, emëruar me aktin nr. 1964 prot., dt. 08.08.2016;
24. ***** “*Specialist Turizmi*”, në Sektorin për Aplikimin e Projekteve, Turizmit dhe Sporteve, emëruar me aktin nr. 1238 prot., dt. 24.05.2017;

25. *****“*Specialist i Sporteve*”, në Sektorin për Aplikimin e Projekteve, Turizmit dhe Sporteve, emëruar me aktin nr.26025 prot., dt.23.09.2019;
26. *****“*Specialist Arsimi*”, në Zyrën e Arsimit, Kulturës dhe Rinisë emëruar me aktin nr. 1175 prot., dt. 02.05.2018;
27. *****“*Specialist i Shërbimit Social*”, në Njësinë Administrative Mesopotam, emëruar me aktin nr. 19, dt. 29.09.2019;
28. *****“*Specialist Protokoll - Arkiv*”, në Njësinë Administrative Aliko, emëruar me aktin nr. 17, dt. 29.09.2015;
29. ***** “*Specialist i shërbimit Social*”, në Njësinë Administrative Aliko, emëruar me aktin nr. 391 prot., dt. 06.02.2018;
30. ***** “*Specialist Protokoll - Arkiv*”, në Njësinë Administrative Dhivër, emëruar me aktin nr. 16, dt. 29.09.2015;
31. ***** “*Specialist i Shërbimit Social*”, në Njësinë Administrative Dhivër, emëruar me aktin nr. 16, dt. 29.09.2015;
32. ***** “*Përgjegjës AMT*”, në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, emëruar me aktin nr.3289, dt. 03.12.2018.

Komisioneri vlerëson se, aktet e mësipërme të emërimit, të cilat kanë dalë në kundërshtim me ligjin, në bazë të pikës 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, janë akte absolutisht të pavlefshëm, qëndrim i cili mbahet edhe prej nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”.

Nisur nga sa më sipër, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë, prandaj bazuar në nenin 111, të ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Finiq, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart; të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve, si dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t’u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e

plotësimi të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Duke u nisur nga rrethanat e evidentuara më sipër, njësia përgjegjëse duhet të kujdeset që të realizojë procedurat e rekrutimit në grup, në nivelin ekzekutiv, duke pasur në vëmendje pikën 8, të nenit 19, të ligjit për nëpunësin civil, e cila i klasifikon pozicionet e punës në grupet e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm dhe grupet e pozicioneve të administrimit posaçëm.

Gjatë analizës të strukturës të Bashkisë Finiq, u konstatua se, **(3)** tre pozicione pune, të cilat kryejnë funksione të emergjencës civile, nuk janë trajtuar si pjesë e shërbimit civil. Bëhet fjalë për dy pozicione pune “*Specialist*” dhe një pozicion “*Përgjegjës Sektori*” në Njësinë e Emergjencave Civile të kësaj bashkie.

Në lidhje me këto pozicione pune, njësia përgjegjëse duhet të marrë masa, që në strukturën e ardhshme këto pozicione pune të përfshihen në skemën e shërbimit civil dhe më pas, njësia përgjegjëse duhet të drejtojë procesin e hartimit të përshkrimit të punës për këto pozicione, duke evidentuar qartazi funksionet, detyrat dhe kompetencat dhe më tej, të shpallë procedurën e konkurrimit për plotësimin e tyre, sipas kërkesave të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “*Procedura hetimore*”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Finiq, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, **32** rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, të evidentuara nominalisht në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.
2. Njësia përgjegjëse të vijojë veprimet administrative për realizimin e procedurave të konkurrimit për të gjitha vendet vakante të plotësuara në kundërshtim me ligjin.

3. Njësia përgjegjëse të përgatisë dhe të miratojë planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për të gjitha pozicionet e mbetura vakant deri në shkurt të vitit 2020, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr. 108, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.
4. Njësia përgjegjëse të marrë masa, që në strukturën e ardhshme tre pozicionet e punës, të cilat kryejnë funksione të emergjencës civile, të trajtohen si pjesë e shërbimit civil dhe më pas, të drejtojnë procesin e hartimit të përshkrimit të punës për këto pozicione, duke evidentuar qartazi funksionet, detyrat dhe kompetencat dhe më tej, të shpallë procedurën e konkurrimit për plotësimin e tyre, sipas kërkesave të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
5. Të përmbillet procesi i mbikëqyrjes i cili është materializuar me vendimin paralajmërues nr. 41, datë 07.05.2018, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Finiq dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, të Komisionerit dhe të vijojë rregullimi i situatës ligjore në këtë subjekt sipas urdhërimeve të dispozitivit të vendimit paralajmërues të Komisionerit, që do të dalë për këtë institucion.
6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **3 (tre) muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Finiq, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjatimit të nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
8. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Finiq, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Finiq, Ministria e Brendshme, si dhe çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha